



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

PROCESVERBAL

**KONSULTIM PUBLIK PËR HARTIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR
KOMUNITETIN ROM DHE EGJIPTIAN**

I mbajtur më 10.10.2025, në orën 12:00 , në dëgjuesën me komunitetin Rom dhe Egjiptian të Bashkisë Kamëz, në lidhje me Hartimin e Planit Vendor të Veprimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian.

Takimi u zhvillua në Sallën e Rinisë, Pallati i Kulturës “Artan Cuku”.

Të pranishëm në takim ishin:

- Drejtoresha e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, znj.Marime Vladi;
- Përgjegjësjë e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, znj.Gentjana Lasku;
- Grupi i Punës;
- Këshilli Bashkiak;
- Shoqëri Civile;
- Komuniteti Rom dhe Egjiptian;
- Ndërlidhësit me komunitetin.

Takimin e hapi Drejtoresha e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, znj.Marime Vladi , e cila falënderoi të pranishmit dhe në mënyrë të veçantë komunitetin Rom dhe Egjiptian për pjesëmarrjen. Ajo u ndal tek Plani Social i Bashkisë Kamëz, i miratuar në vitin 2024, duke theksuar një nga pikat kryesore të tij: Hartimin e Planit Vendor të Veprimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian. Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian është rezultat i punës së një grupi të angazhuar ekspertësh dhe përfaqësuesish institucionalë, të cilët, mbi bazën e

vëzhgimeve në terren dhe analizës së nevojave reale, kanë përgatitur një dokument paraprak që sot po paraqitet për konsultim me komunitetin dhe grupet e interesit.

Me pas, fjala i kaloi Përgjegjëses së Njesisë së Vlersimit të Nevojave dhe Referimit, znj. Gentjana Lasku, e cila pasi falënderoi të pranishmit u ndal tek Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian, duke theksuar se:

“Një nga pikat kryesore të Planit Social të Bashkisë Kamëz është hartimi i Planit Vendor të Veprimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian. Plani është hartuar në bashkëpunim me të gjitha grupet e interesit dhe grupet e punës. Sot jemi mbledhur së bashku me grupin e punës dhe përfaqësues të komunitetit Rom dhe Egjiptian, për të diskutuar përmbajtjen e tij dhe për të përfshirë nevojat dhe kërkesat konkrete në planin vendor. Plani parashikon aktivitete konkrete në fusha të tilla si regjistrimi në gjendjen civile, arsimimi, kujdesi shëndetësor, punësimi, formimi profesional, strehimi dhe mbrojtja sociale. Do të zhvillohen aktivitete ndërgjegjëse për të gjitha këto fusha, me qëllim që komuniteti Rom dhe Egjiptian të ketë akses dhe të përfitojë nga shërbimet publike,” u shpreh ajo.

Në fjalën e saj, znj.Lasku u ndal në disa nga çështjet më të rëndësishme që prekin komunitetin Rom dhe Egjiptian. Ajo theksoi gatishmërinë për bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e Bashkisë Kamëz: “Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me të gjitha drejtoritë e Bashkisë Kamëz, veçanërisht për problematikat që lidhen me gjendjen civile, që mbetën të shumta dhe të ndjeshme. Nga janari i vitit 2026, për çdo fëmijë të lindur do të jepet një pagesë mujore për pesë vite. Braktisja e shkollës nga fëmijët e komunitetit është një nga sfidat më serioze, ndaj kemi parashikuar aktivitete ndërgjegjëse për rëndësinë e arsimit si mjet kyç për zhvillim. Po ashtu, në bashkëpunim me qendrat shëndetësore, do të ndërmerren nisma për vaksinimin, kontrollin shëndetësor dhe higjienën. Në fushën e punësimit dhe formimit profesional, do të ofrohen programe të posaçme dhe kurse falas për të rinjtë, për të lehtësuar përfshirjen në tregun e punës. Bashkia ofron gjithashtu mbështetje nëpërmjet bonuseve të qirasë, ndihmës ekonomike, pakove ushqimore, si dhe çerdheve e kopshteve falas për familjet në nevojë. Të gjitha këto masa janë pjesë e një plani pesëvjeçar që synon përfshirjen aktive dhe përmirësimin e jetës së komunitetit Rom dhe Egjiptian,” u shpreh ajo.

Nga vëzhgimet në terren situatë aktuale e komunitetit Rom dhe Egjiptian paraqitet si mëposhtë:

➤ **Arsimimi**

Në Bashkinë Kamëz aktualisht kemi 23 shkolla, 22 kopshte dhe 4 çerdhe të cilat përmbushin të gjitha kushtet e nevojshme për një arsim cilësor të fëmijëve.

Nga të dhënat e siguruar nga Zyra Arsimore Vendore përse i përket komunitetit Rom dhe Egjiptian na rezulton se ndjekin;

- Arsimin 9-vjeçar 364 fëmijë të komunitetit Romë dhe Egjiptian, nga këto 44.7% femra.
- Arsimin e mesëm profesional 15 fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian të cilët përfitojnë bursë, ku 4 prej tyre janë femra.
- Në kopshte dhe çerdhe janë të regjistruar dhe ndjekin rregullisht arsimin parashkollor 48 fëmijë, ku 22 prej tyre janë femra, që përfitojnë shërbimin falas.

➤ **Shërbimi Shëndetësor**

Për të gjithë personat e pajisur me kartë shëndeti mjeku specialist ofron shërbimin falas, ndërsa për të tjerët sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Në Bashkinë Kamëz po realizohet një studim në terren përse i përket aspektit shëndetësor të familjeve romë dhe egjiptiane, në mënyrë që të mbledhim të dhëna statistikore dhe cilësore të sakta për krijimin e një database të saktë.

➤ **Punësimi, formimi dhe edukimi profesional**

- Bashkia Kamëz në bashkëpunim me zyrat e punës dhe nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit ka të punësuar në administratën e saj 70 punonjës të komunitetit Rom dhe Egjiptian.
- Bashkia Kamëz për të promovuar rritjen e iniciativave private në biznes ka krijuar disa lehtësira për taksat e bizneseve të regjistruar dhe drejtuar nga persona të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Janë gjithsej 16 subjekte private të drejtuar nga anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian të cilët kanë përfituar lehtësira fiskale dhe reduktim të taksave të biznesit.
- Janë 4 subjekte private të cilat përfitojnë reduktim të tarifës dhe lehtësira fiskale për të siguruar rikuperim dhe qëndrueshmëri afatgjatë të biznesit.

- 4 subjekte të tjera kanë përfituar reduktim të taksave vendore në masën 50%.
- 5 subjekte private të drejtuar nga komuniteti Rom dhe Egjiptian janë mbështetur për tu formalizuar në biznese të rregullta.
- 2 biznese janë pajisur me leje për zhvillimin e aktiviteteve ambulatorë në hapësirat publike dhe janë përjashtuar nga tarifat financiare.
- 1 subjekt i drejtuar nga anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian ka përfituar hapësirë tregtare të caktuar.

➤ **Strehimi**

- Në Bashkinë Kamëz mbulohet programi i subvencionimit të qerasë në treg të lirë në të cilin përfitojnë bonus qeraje 11 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian, ndërsa 1 familje e komunitetit përfiton nga programi me kosto të ulët.
- 66 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian në territorin e Bashkisë Kamëz janë përfituese të programeve të ndryshme nga procesi i rindërtimit ku:
 - ✓ 20 familje janë përfituese të programit DS1;
 - ✓ 23 familje janë përfituese të programit DS2;
 - ✓ 12 familje janë përfituese të programit DS3;
 - ✓ 4 familje janë përfituese të programit DS4;
 - ✓ 2 familje janë përfituese të programit DS5;
 - ✓ 4 familje janë përfituese në zonën e re për zhvillim Valias;
 - ✓ 1 familje është mbështetur me një grant prej 2.800.000L për ta rindërtuar banesën e dëmtuar vetë.

➤ **Mbrojtja sociale**

Në Bashkinë Kamëz përgjatë vitit 2024 kanë aplikuar në sistemin e ndihmë ekonomike 101 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian. 58 familje të komunitetit (251 anëtarë) kanë përfituar ndihmën ekonomike.

- 46 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian (211 anëtarë) trajtohen me ndihmë ekonomike nga Sistemi Elektronik i Ndhmës Ekonomike.

- 5 familje (6 anëtarë) të komunitetit Rom dhe Egjiptian trajtohen me ndihmë ekonomike nga Fondi 6% i Bllok- Ndihmës Ekonomike.
- 7 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian (34 anëtarë) trajtohen me ndihmë ekonomike nga Fondi i Buxhetit të Bashkisë Kamëz.

Nga MKR është mbështetur 1 person i komunitetit dhe 2 persona të komunitetit janë të pajisur me UMM dhe UM.

7 fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian janë mbështetur me shërbime të ndryshme nga Njësia e Mbrotjes së Fëmijës ku 4 prej tyre janë femra.

Qëllimet dhe Objektivat e Planit Vendor të Veprimit për Komunitetin Rom dhe Egjiptian.

- Romët dhe Egjiptianët me akses në shërbimet e gjendjes civile.
 - 1- Përmirësimi i aksesit në shërbimet e gjendjes civile.
 - 2- Ndërgjegjësim i komunitetit për rëndësinë e të pasurit identitet.
- Rritja e nivelit arsimor të komunitetit Rom dhe Egjiptian.
 - 1- Rritja e numrit të fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin të gjithë nivelet e arsimimit.
 - 2- Ndërgjegjësim i komunitetit për rëndësinë dhe ndikimin e arsimimit në rritjen e mirëqënies.
- Kujdes shëndetësor të aksesueshëm dhe të përballueshëm për romët dhe egjiptianët.
 - 1- Përmirësimi i aksesit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në shërbimet e kujdesit shëndetësor.
 - 2- Përmirësimi i informimit dhe promovimit shëndetësor për Romët dhe Egjiptianët.
- Rritja e mundësive për punësim dhe punë të denjë.
 - 1- Rritja e aksesit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në kurset e formimit profesional.
 - 2- Rritja e qëndrueshmërisë në punët formale të anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian.
- Kushte të përshtatshme banimi për romët dhe egjiptianët.
 - 1- Rritja e aksesit të komunitet Rom dhe Egjiptian në programet e strehimit social.

2- Ndërgjegjësim i komunitetit mbi higjenën personale.

- Rritja e nivelit të mirëqënies në familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian

- 1- Përmirësimi i aksesit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në programet e mbrojtjes sociale;
- 2- Zgjerimi i hartës sociale për përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve në programe të ndryshme.

Secilit pjesëmarrës në takim iu dha mundësia dhe koha për t'u përfshirë në diskutimin e ngritur me kërkesa, sugjerime dhe pyetje, se çfarë mund të ofrojë Bashkia Kamëz për mbështetjen dhe zgjidhjen e problemeve.

Diskutime

Përfaqësuesja e Qendrës për të Drejtat e Gruas Rome, Znj. Manjola Veizi

Ju përgëzoj për nismën dhe për fushat ku po përqendroheni. Do të doja të ndalesha tek arsimi, që është përfshirë si një nga pikat e planit. Mendoj se problemi i arsimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian nuk qëndron vetëm te mungesa e ndërgjegjësimit. Shumë prindër të këtij komuniteti kanë dëshirë t'i çojnë fëmijët në shkollë, por nuk kanë mundësi ekonomike. Fëmijët, kur shohin bashkëmoshatarët e tyre të veshur mirë dhe që kanë një vakt për të ngrënë, ndihen të përjashtuar dhe rrjedhimisht largohen nga shkolla.

Dua të sjell në vëmendje se Qeveria Shqiptare ka miratuar VKM nr. 666, që është pjesë e skemës së mbështetjes, por shpesh ndodh që familjet në nevojë nuk përfshihen, pasi kush trajtohet me ndihmë ekonomike nuk përfiton bursë. Kjo është një barrë për familjet që nuk kanë të ardhura.

Përgjegjësjë e NJVNR-ës, znj. Gentjana Lasku

Ju falënderoj për shqetësimet e ngritura, të cilat do të shqyrtohen me kujdes për t'u përfshirë në hartimin e Planit të Veprimit. Aktualisht në shkollat e Bashkisë Kamëz janë 15 fëmijë të

komunitetit Rom dhe Egjiptian që përfitojnë bursë. Dua të theksoj se kopshtet dhe çerdhet në Bashkinë Kamëz ofrojnë mëngjes dhe drekë për fëmijët, ku familjet rome dhe egjiptiane i kanë përfituar këto shërbime pa pagesë.

Përfaqësuesja e QDGR, Znj. Manjola Veizi

Një tjetër problematikë është përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e shërbimeve. Procesi i digjitalizimit ka krijuar vështirësi të mëdha për këto komunitetin . Ka shumë familje që, për shkak se nuk kanë ditur të aplikojnë në e-Albania, kanë dalë jashtë skemës së ndihmës ekonomike.

Përgjegjësjë e NJVNR-ës, znj.Gentjana Lasku

Bashkia Kamëz ka ofruar asistencë në çdo njësi administrative për përdorimin e e-Albania. Në çdo njësi ka specialistë të dedikuar që ndihmojnë qytetarët falas me aplikimet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar shërbime.

Përfaqësuesja e QDGR, Znj. Manjola Veizi

Sa i përket martesave të hershme, dua të theksoj se është një koncept i gabuar të thuhet “kështu e kanë në traditë”. Ligji është ligj dhe duhet të zbatohet. Institucionet arsimore duhet të raportojnë mungesat e vajzave në shkollë pranë punonjësve socialë të Bashkisë, të cilët nga ana e tyre duhet të njoftojnë prindin ose, në raste të caktuara, edhe policinë, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni.

Përgjegjësjë e NJVNR-ës, znj.Gentjana Lasku

Kjo është edhe arsyeja pse po hartohet Plani Vendor i Veprimit për të përfshirë të gjitha institucionet përkatëse në adresimin e këtyre çështjeve. Shkollat me të cilat kemi bashkëpunime të mira raportojnë rregullisht për frekuentimin e nxënësve, dhe janë ndërmarrë vizita në familje për të kuptuar arsyet e mungesave. Gjithashtu, janë përfshirë aktivitete ndërgjegjësuëse dhe trajnime për vetë punonjësit, mbi mënyrën se si të veprojnë dhe të raportojnë rastet e martesave të hershme.

Përfaqësuesja e QDGR, Znj. Manjola Veizi

Një tjetër shqetësim i ngritur nga komuniteti është regjistrimi i fëmijëve në kopshte. Dua t'ju përgëzoj për ushqimin falas që ofrohet për këtë komunitet. Megjithatë, regjistrimi në kopshte vazhdon të jetë një sfidë për shumë nëna të reja që duan të punojnë, por nuk kanë se ku t'i lënë fëmijët.”

Përgjegjësjë e NJVNR-ës, znj.Gentjana Lasku

Bashkia ka bërë maksimumin për të regjistruar fëmijët në kopshte, madje duke tejkaluar kapacitetet në rastet kur nëna ka gjetur punë. Megjithatë, problematikat shpesh nuk lidhen me mungesën e vendeve, por me mungesën e dokumentacionit ose me faktin që nëna nuk është realisht e punësuar. Për të gjitha rastet ku është paraqitur një mundësi punësimi, fëmijët janë regjistruar. Duhet theksuar se problemet me gjendjen civile pengojnë shumë nga shërbimet që Bashkia ofron.

Në fund të diskutimit, Drejtoresha e Ndiemes Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, znj.Marime Vladi, falënderoi të pranishmit duke thënë se kërkesat, sugjerimet dhe idetë e tyre do të diskutohen dhe do të merren parasysh për t'u implementuar në Hartimin e Planit Vendor të Veprimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian.



